



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:144431
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05744100

Pml.nr.286/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit N. B., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësja e të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri P.nr.632/2019 të datës 26.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nr.2019:144431 të datës 29.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit N. B. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri P.nr.632/2019 të datës 26.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nr.2019:144431 të datës 29.03.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me aktgjykimin P.nr.632/2019 e datës 26.10.2023, të dënuarin N. B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 60 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 20 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin, nr.2019:144431 e datës 29.03.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit, avokate Kada Bunjaku- Perçuku nga V., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthen në rigjykim ose i dënuari të lirohet nga akuza.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.161/2024 e datës 14.05.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësja e të dënuarit thekson se i dënuari me aktgjykimin sipas urdhrit ndëshkimit ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, me ç'rast i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) € dhe i cili dënim nuk do të ekzekutohej nëse në periudhën prej 1 (një) viti nga koha kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen veprën penale. Duke pasur parasysh se kundër këtij aktgjykimi kundërshtim ka paraqitur vetëm i dënuari por jo edhe prokuroria e shtetit, atëherë me rastin e aprovimit të kundërshtimit dhe gjykimin të rastit të dënuarit i është shqiptuar dënim

efektiv me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) € dhe i cili dënim është ndryshuar në dëm të të dënuarit dhe me këtë rast është shkelur parimi i përcaktuar me nenin 395 të KPP-së.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar ligjin penal duke aplikuar Kodin Penal të Kosovës Kodi.nr.06/L-074 i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale pasi që vepra penale pretendohet se është kryer me datë 26.06.2018 kur në fuqi ka qenë Kodin Penal të Kosovës - Kodi.nr.04/L-082 edhe pse ky kod ka qenë më ashpër për dënimin e paraparë por ka qenë më i favorshëm në pjesën e përgjithshme.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimet e theksuara përkitazi me aplikimin e parimit reformatio in peius të përcaktuar me dispozitë e nenit 395 të KPP-së nuk vlejné për rastet kur të dënuarit i shqiptohet dënimi sipas urdhrin ndëshkimor pasi që me dispozitën e nenit 497 të KPP-së është përcaktuar se ndalesa e dispozitës së nenit 395 të KPP-së nuk është e zbatueshme për rastet kur kundër të dënuarit është shqiptuar dënimi sipas urdhrin ndëshkimor, përkatësisht se gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit pas kundërshtimit nuk detyrohen në këtë ndalesë, andaj edhe dënimi i shqiptuar është në përputhje të plotë me këtë dispozitë specifike e cila ka përcaktuar se ndalesa në fjalë nuk vlen për rastet e procedura sipas urdhrin ndëshkimor, siç është vepruar me të drejtë edhe në rastin konkret.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pjesën e kërkesës përkitazi me aplikimin e ligjit penal, konstatoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka aplikuar ligjin penal dhe duke pasur parasysh faktin se nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë

vërtetohet se vepra penale ishte kryer me datë 26.06.2018 e që në këtë kohë në fuqi ishte Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi.nr.04/L-082 e që vepra penale ishte paraparë me dispozitën e nenit 320 të KPRK-së (vjedhja e shërbimeve komunale) për të cilën ishte paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet, kurse në ndërkohë ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi.nr.06/L-074 e që vepra penale ishte paraparë me dispozitën e nenit 314 të KPRK-së (vjedhja e shërbimeve) për të cilën ishte paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet. Andaj nga krahasimi i këtyre dispozitave ligjore në mënyrë të qartë del se Kodi.nr.06/L-074 është më i favorshëm, meqë ka paraparë dënim alternativ, përkatësisht dënim me gjobë ose me burgim, për dallim prej Kodit nr. 04/L-082 i cili kishte paraparë dënim kumulativ, pra dënim me gjobë dhe me burgim, andaj pretendimet se është aplikuar ligji më i pa favorshëm kundër të dënuarit del të jetë pretendim i pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.286/2024, më 22 maj 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi